



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 20.2.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS SË PRESIDENTIT TË
KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Zyrës së Presidentit të Kosovës në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Emine Fazliu, e mbështetur nga, Faruk Rrahmani -Udhëheqës Ekipi, dhe Mazlumsha Sejfadini - Anëtar Ekipi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	13
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	19
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	20
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak	23


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Zyrës së Presidentit të Kosovës për vitin 2015 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2015 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë e reflekton qasjen e paraqitur në Memorandumin e Planifikimit të datës 23 tetor 2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I) :



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat vjetore financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale. Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi në pjesën 1.2 të këtij raporti.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:

Menxhimi i rrezikut dhe zbatimi i rekomandimeve të vitit paraprak nuk është adresuar ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.



Sekretari duhet të zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që procesi i vetvlerësimit dhe rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive, ku progresi i raportohet menaxhmentit në baza mujore. (shih çështjet 1,2 dhe 3)

Menaxhimi i proceseve të prokurimit kishte mangësi sidomos te procedurat e kuotimit.



Sekretari duhet të sigurojë se dobësitë në procesin e prokurimit janë evituar dhe se rregullat e prokurimit dhe kriteret e kërkuara në dosje të tenderit respektohen në plotësi para se të nënshkruhet kontrata. (shih çështjen 5)

Përgjigja e Menaxhmentit të ZPK-së - auditimi 2015

Menaxhmenti i ZPK-së ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në pasqyra financiare. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Zyrës së Presidentit të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat vjetore financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të pranimeve dhe të pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të Zyrës së Presidentit të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga Zyra e Presidentit të Kosovës dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Sekretari i Përgjithshëm i Zyres së Presidentit të Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Sekretari i Përgjithshëm dhe menaxhmenti i ZPK-së janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyres së Presidentit të Kosovës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

PVF-të e ZPK-së duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren nr. 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Kërkesat që PVF-të janë përgatitur në gjuhën Shqipe dhe Serbe, janë nënshkruar nga ZKA dhe ZKF si dhe janë dorëzuar në MF; dhe
- Kërkesat e Rregulloreve 01/2013 - Shpenzimi i parave publike dhe nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare.

Në pasqyrat financiare ishin të nevojshme disa korigjime teknike si në tabelat e para ashtu edhe në pjesën e shënimeve shpjeguese. Për të siguruar raportimin e saktë ne sugjeruam korigjimet si në vijim:

- *Neni 12 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave dhe te tabelat e shpalosjeve* - vërejtëm se shumat e prezantuara në pasqyra nuk ishin rrumbullaksuar si duhet në mijë/Euro; dhe
- *Shenimi 34 Të arkëtueshmet* - vërejtëm se pasuria kontingjente në vlerë prej 42,840€ e viteve paraprake që ishte kontest gjyqësor ishte prezentuar te të arkëtueshmet. Meqenëse ZPK nuk mbledh të hyra dhe nuk ka të arkëtueshme, ne sugjeruam që kjo shpalosje të bëhet te shënimi 29 Detyrimet kontingjente/Pasuritë kontingjente.

Pas sugjerimeve tona ZPK ka korigjuar PVF-të dhe versionin final i prezantuar nuk përmban ndonjë gabim. Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm nga ZPK kërkohet të adresoj raportimet si në vijim:

- Kërkesat Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Draft plani dhe plani final i prokurimit;
- Raportet mbi obligimet e dorëzuara në MF;
- Raporti i vetvlerësimit sipas rregullave të MFK-së; dhe
- Raporti vjetor i performancës.

Të gjitha kërkesat për raportim si në kontekst të PVF-ve dhe raportimit të jashtëm ishin përmbushur dhe kishin një cilësi të mirë dhe ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për ZPK-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

- Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda ZPK-së, veçanërisht në lidhje me implementimin e rekomandimeve nga viti paraprak dhe menaxhimin e rrezikut. Lista kontrolluese e vetvlerësimit, e plotësuar e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese.

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh nëpër sistemet financiare. Ne kemi konstatuar se kontrollat në disa fusha kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që ZPK të ketë vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv. Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë implementimi i rekomandimeve, eliminimi i mangësive të konstatuar nga vetvlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut si një komponentë shumë e rëndësishme.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 ka rezultuar me gjashtë rekomandime. ZPK ka përgatitur një plan veprimi për të siguruar se rekomandimet do të adresohen brenda periudhës së specifikuar. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, ZPK kishte arritur të implementojë tre rekomandime, dy ishin në proces ndërsa një nuk ishte implementuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar, shih Shtojcën III.

Çështja 1 - Implementimi i rekomandimeve të vitit paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura	Rekomandimi i paimplementuar ka të bëjë me sistemin e-pasuria i cili ende nuk ishte instaluar në ZPK. ZPK heziton në instalimin e sistemit e-pasuria pasi që aplikon një softuer të krijuar nga zyrtaret e ZPK-se dhe se evidencat e mbajtura janë të sakta dhe të plota. Mangësitë ishin përsëritur edhe në fushën e prokurimit.
Rreziku	Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve të tjera në sisteme kyçe financiare dhe të cilat nuk janë implementuar plotësisht, kanë rezultuar në: <ul style="list-style-type: none">• Mangësi në procedurat e prokurimit; dhe• Mos funksionalizimin e sistemit e-pasuria.
Rekomandimi 1	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se plani i veprimit rishikohet në vazhdimësi në mënyrë që të përcaktoj një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës, me fokus fillestar në fushat e një rëndësie më të madhe.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese.

Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për ZPK-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin Vjetor të Auditimit të ZAP-it. Kjo nuk ka për qëllim të japë komente për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 - Lista kontrolluese e vetvlerësimit - Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, ne i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponente. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

- Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur plotësisht, pasi që nuk ishte hartuar ndonjë plan operativ për menaxhimin e rreziqeve kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1; dhe
- Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura nga ZPK.

Auditimi i Brendshëm nuk i ka theksuar çështjet më lart. Për më shumë, veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetvlerësimi i vitit 2014 është i limituar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda ZPK-së që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

Rreziku Aranzhimet e dobëta të qeverisjes dobësojnë proceset strategjike dhe operacionale si dhe zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 2 Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit ZPK operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara me procedurat e MFK dhe rregullës 01/2010 kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv, operacional dhe strategjik.

Çështja 3 – Moszbatimi i plotë i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut – Prioritet i lartë

- E gjetura** Pyetësi i vetvlerësimit i plotësuar nga ZPK ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut ishin në fazën fillestare. ZPK kishte hartuar një plan vjetor të punës ku për fusha operative kishte identifikuar rreziqet e mundshme mirëpo nuk kishte paraparë ndonjë plan veprimi për menaxhimin e këtyre rreziqeve.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut ndikon në cilësinë e objektivave pasi që rreziqet nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet proaktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
- Rekomandimi 3** Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut te një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë duke monitoruar menaxhimin e rreziqeve.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) gjatë vitit 2015 ka funksionuar me një staf – që ishte edhe Drejtor i NjAB. NjAB ka hartuar planin strategjik që përfshinë periudhën 2014-2016 dhe planin vjetor. Plani vjetor ishte mbështetur në planin strategjik dhe ishte hartuar në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe prioritetëve të tyre.

Auditimi i brendshëm kishte planifikuar auditim në: shpenzimet për punët jashtë orarit, menaxhimin e veturave zyrtare, menaxhimin e pasurive dhe procedurat e prokurimit. Prej këtyre auditimeve të planifikuara vetëm menaxhimi i pasurive nuk ishte kryer. Po ashtu auditimi për arkivën i planifikuar për vitin 2014 ishte finalizuar në vitin 2015.

Në këto raporte, NjAB kishte dhënë 14 rekomandime lidhur me përmirësimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm. Një pjesë e këtyre rekomandimeve ishin implementuar ndërsa pjesa tjetër ishin në proces të implementimit. Përderisa rekomandimet e dalura nga raporti për arkivën nuk ishin implementuar.

Komiteti i auditimit (KA) kishte mbajtur katër takime të rregullta gjatë vitit, dhe se kishte vlerësuar dhe trajtuar çështjet e ngritura në raportin e ZAP-it si dhe çështjet e ngritura nga raportet e auditimit të brendshëm.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh nëpër sistemet kyçe financiare. Ne kemi konstatuar se, kontrollet në disa fusha kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që ZPK të ketë vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv.

Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë menaxhimi i proceseve të prokurimit, kontrollet mbi shpenzimet dhe gjetja e një zgjidhje për sistemin e-pasuria.

3.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për ZPK si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – shpenzimi kundrejt buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	1,853,923	1,693,674	1,615,564	1,563,370	1,474,314
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,853,923	1,669,598	1,615,564	1,563,370	1,474,314
Grant i Amb. Norvegjeze	0.00	24,076	0.00	0.00	0.00

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 160,249€. Me rishikim buxheti ishte zvogluar për 200,306€ duke vazhduar me ripërshtatje të buxhetit sipas vendimeve të Qeverisë deri në fund të vitit. Në vitin 2015, ZPK ka përdorur 95% të buxhet final ose 1,615,564€, me një përmirësim prej 6% krahasuar me vitin 2014.

Po ashtu në dhjetor të vitit 2015 ZPK, ka nënshkruar një marrëveshje me Ambasaden Norvegjeze² për përfitimin e një donacion në vlerë 48,152€. Ky donacion kishte për synim fuqizimin dhe

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² 460,000 NOK - Kruna Norvegjeze

mbështetjen e Këshillit Konsultativ për Komunitete. Shuma prej 24,076€ ishte alokuar në buxhetin e vitit 2015 e cila nuk ishte shpenzuar. Pritet që ky donacion të realizohet gjatë vitit 2016.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike-shpenzimi ndaj buxhetit (€)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,853,923	1,693,674	1,615,564	1,563,370	1,474,314
Pagat dhe Mëditjet	823,751	722,484	722,484	624,910	547,820
Mallrat dhe Shërbimet	861,472	898,575	821,693	876,599	885,012
Shërbimet komunale	18,700	10,197	10,197	10,487	12,206
Subvencione dhe Transfere	70,000	42,418	42,418	51,374	29,276
Investimet Kapitale	80,000	20,000	18,772	0	0

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti për kategorin e pagave dhe medijtjeve ishte planifikuar për 70 zyrtarë, ndërsa numri i zyrtarëve ishte 60. Në mungesë të hapsirës për vendosje të stafit, ZPK nuk kishte zhvilluar procese të rekrutimit për plotësimin e të gjitha pozitave të planifikuara. Me rishikim të buxhetit kategoria e pagave dhe mëditjeve ishte zvogëluar për 109,255€. Ndërsa në fund të vitit bazuar në vendim të Qeverisë shuma prej 7,988€ i është shtuar ZPK-së në këtë kategori;
- Me rishikim të buxhetit kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishte zvogëluar për 91,051€, ndërsa në nëntor me vendim të Qeverisë nr. 07/60 për këtë kategori janë ndarë mjete në vlerë prej 105,000€. Po ashtu edhe donacioni norvegjez në vlerë prej 24,076€ ishte alokuar në këtë kategori. Shpenzimet në këtë kategori janë realizuar 91%;
- Shërbimet komunale në fund të vitit, me vendim të Qeverisë, ishte zvogëluar për 8,503€. Zvogëlim kishte edhe kategoria e subvencioneve dhe transfereve në vlerë prej 27,582€. Shpenzimet në këto dy kategori ishin realizuar 100%; dhe
- Shuma prej 60,000€ i është marrë ZPK nga kategoria e investimeve kapitale si tepriçë buxhetore nga Ministria e Financave. Nga kjo shumë 40,000€ ishin të projektit për ndërtimin e zyrës për presidencën "Projekti i Shtëpisë së Bardhë" i cili nuk kishte filluar. Shpenzimet në këtë kategori janë realizuar 94% krahasuar me buxhetin final.

3.4 Prokurimi

Rregullat e prokurimit kanë për qëllim të sigurojnë që fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore i definon qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit.

Vlera e kontratave të nënshkruara në vitin 2015 ishte 495,161€. Prej 56 procedurave të zhvilluara, 50 prej tyre ishin me procedurën e kuotimit. Ne testuam shtatë prokurime nga kategoria mallra-shërbime dhe dy nga investimet kapitale në vlerë totale prej 248,683€. Auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e dobësive në prokurim lidhur me përdorimin jo të duhur të procedurave të prokurimit dhe pranimin e sigurimit të ekzekutimit jo në përputhje me kërkesat në dosjen e tenderit.

Çështja 4 - Dobësitë jo-sistematike të prokurimit - Prioritet i lartë

E gjetura Nga rishikimi i kontratave, kemi identifikuar se disa kontrole menaxheriale ndaj aktiviteteve të prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë dhe kjo ka rezultuar si më poshtë:

- Në dosjen e tenderit "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të tipit Toyota", ishte kërkuar sigurimi i ekzekutimit prej 10% të vlerës së ofertës fituese. Kontrata kornizë ishte në vlerë prej 57,324€ sipas çmimit për njësi. Siguria e ekzekutimit bazuar në vlerën e kontratës duhej të ishte 5,732€, përderisa AK kishte pranuar nga fituesi i kontratës sigurinë e ekzekutimit në vlerë 3,000€; dhe
- Procedura e kuotimit të çmimeve kërkon nga AK që të kuotoj gjithë sasinë e artikujve që planifikon të furnizohet. Në dosjen e tenderit "Shërbimet e sigurimeve shëndetësore" (për udhëtime jashtë vendit), AK ka përdorur procedurën e kuotimit të çmimeve, ndërsa specifikimi ishte bërë për çmime për njësi duke mos e përcaktuar sasinë që do ta kërkoj (furnizoj). Oferta e fituesit ishte me çmim 2,834€, përderisa kontrata ishte nënshkruar me dyfishin e vlerës së ofertës (5,668€) e që është në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.

Rreziku Në mungesë të sigurimit të plotë të ekzekutimit, AK i ka mundësitë e kufizuara për ta detyruar OE të respektojë kushtet e kontratës dhe rrezikon që kontrata të mos përmbushet. Gjithashtu mos definimi i sasisë së kërkuar në dosje të tenderit të kuotimet nga AK dhe nënshkrimi i kontratës jo në përputhje me ofertën fituese rritë rrezikun që, AK të mos jetë në gjendje të menaxhoj procesin e prokurimit, si duhet dhe si pasojë të mos marrë vlerën për paranë.

Rekomandimi 4 Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se dobësitë në procesin e prokurimit janë evituar dhe se rregullat e prokurimit dhe kriteret e kërkuara në dosje të tenderit respektohen në plotësi para se të nënshkruhet kontrata. Po ashtu Sekretari duhet të siguroj se departamenti i prokurimit analizon paraprakisht se cila nga procedurat e prokurimit do të ishte më e përshtatshme për secilin tender që planifikon ta shpallë. Për lidhjen e kontratës për çmimet për njësi duhet të shfrytëzohet kontrata kornizë.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Shpenzimet jo përmes prokurimit nënkuptojnë të gjitha ato blerje të cilat nuk kërkojnë aplikimin e procedurave të prokurimit publik. Ne kemi testuar shpenzimet e reprezentacionit, telefonisë dhe drekave zyrtare ku identifikua mangësitë si në vijim:

Çështja 5 - Shpenzime përtej limiteve të lejuara - Prioritet i mesëm

E gjetura Me UA të brendshëm të datës 03.08.2015, rregullohen rastet e tejkalimeve të limiteve për shpenzimet e telefonisë mobile. Për shpenzimet e paarsyetuara mjetet duhet të rimbursohen, përderisa kur ka arsye duhet të aprovohet nga menaxheri përgjegjës. Shpenzimet e telefonisë mobile ishin 46,590€. Nga tre pagesat e testuara në vlerë prej 8,556€ vërejtëm se stafi i kabinetit të Presidentes kishte tejkeluar limitin e shpenzimeve të telefonisë mobile për 2,966€. Edhe përkunder njoftimeve të vazhdueshme për keto tejkalime nga Sekretari, kjo dukuri kishte vazhduar deri në tetor, kur edhe kishte filluar që të aplikohet aprovimi i tejkalimeve të shpenzimeve të telefonit; dhe

Me UA nr. 01/2014 të datës 28.01.2014 përcaktohen të drejtat dhe kufizimet për shpenzimet e reprezentacionit (Byfe). Në pagesën e testuar në vlerë prej 3,207€, konstatoam se shpenzimet në vlerë totale prej 669€ nuk ishin të lejuara sipas këtij udhëzimi. Pas memos së auditimit në fund të dhjetorit menaxhmenti ka nxjerr një udhëzim i cili rregullon tarifat e lejuara për këtë lloj të shpenzimit.

Rreziku Shpenzimet jashtë rregullave të vendosura dhe tejkalimet e vazhdueshme rrisin rrezikun që buxheti të shpenzohet në mënyrë jo racionale dhe jo në përputhje me planin. Nëse nuk ka ndalesa ose sanksione për tejkalime atëherë kontrollet bëhen jo efektive.

Rekomandimi 5 Sekretari i Përgjithshëm duhet të forcoj nivelin e kontrollit mbi menaxhimin e shpenzimeve të telefonisë dhe reprezentacionit për të racionalizuar ato. Në rastet shumë specifike mund të ketë tejkalime dhe vetëm për ato raste duhet të bëhet aprovimi por që tejkalimet nuk duhet të bëhen dukuri. Për tejkalime të cilat nuk kanë aprovim, duhet aplikuar ndalesa nga paga.

3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payroll). Kontrollat që operojnë në nivel qendror nga ZPK kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj duke nënshkruar listen e pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundëshme që mund të paraqiten përmes formularëve dhe rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Në rishikim listat e pagave si dhe krahasuam të dhënat e prezantuara nga Thesari - SIMFK dhe prezantimin e tyre në PVF. Po ashtu kemi testuar mostra, duke përfshirë dosjet e personelit dhe kompensimet për shtesa dhe punë jashtë orarit. Bazuar në këtë kemi konstatuar se ZPK, ka vendosur sisteme të mira të kontrollit mbi fushën e kompensimeve (pagave dhe mëditjeve).

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.6 Pasuritë dhe obligimet

3.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Kemi rishikuar procesin e menaxhimit të pasurive dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës së pasurisë nëse janë mbajtur në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore.

Nga analiza e PVF-ve vërehet se të dhënat e prezantuara në PVF janë në përputhje me evidencat e regjistrit kontabël, regjistrin që mbanë organizata për pasuritë me vlerë nën 1,000€ dhe stoqet.

Çështja 6 - Sistemi "e - pasuria"- Prioritet i mesëm

E gjetura Rregullorja nr. 02/2013 thekson se pasuritë kapitale duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël - SIMFK ndërsa pasuritë jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria".

ZPK nuk e ka të instaluar softuerin "e - pasuria". Megjithatë ZPK ka mbajtur evidenca të sakta dhe të plota për pasuritë me vlerë nën 1,000€ dhe aplikon një softuer që kalkulon zhvlerësimin saktë dhe gjeneron informata dhe raporte të plota dhe të sakta.

Rreziku Mos instalimi i sistemit "e-pasuria" është në kundërshtim me rregulloren 02/2013 dhe kjo e nxjerr institucionin jashtë mbikqyrjese së MAP-it në lidhje me menaxhimin e pasurive.

Rekomandimi 6 ZKA duhet të diskutojë me MAP-in dhe rishikoj mundësitë e gjetjes së një zgjidhje për sistemin e-pasuria. Instalimi i sistemit e-pasuria apo një zgjidhje që mund të gjendet në kuadër të dy institucioneve do të jetë e pranueshme.

3.6.2 Trajtimi i obligimeve

ZPK ka prezantuar obligimet e papaguara në PVF-të e vitit 2015. Vlera e tyre ishte 67,180€, apo për 47,358€ më shumë se obligimet e vitit 2014. Obligimet e papaguara kryesisht i takojnë muajit dhjetor. Arsyeja e mospagesës ishte mungesa e buxhetit pasi që ZPK kishte një reduktim të buxhetit me rishikim në kategorinë mallra dhe shërbime.

Raportimi mujor në thesar ishte bërë me kohë dhe në harmoni me rregullën financiare për raportimin e obligimeve, dhe ne nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi e cila do duhej shqyrtuar në këtë raport.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornizë për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk përhapen në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë materiale por nuk përhapen.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe përhapen në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë edhe materiale edhe të përhapen. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 170519 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
Prokurimi	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se departamenti i prokurimit aplikon në tërësi rregullat e prokurimit si ato formale ashtu edhe ato përmbajtësore. Për lidhjen e kontratës për çmimet për njësi AK duhet të shfrytëzoj kontratën kornizë e jo procedurën e kuotimit të çmimit.		Pjesërisht pasi që pjesa në lidhje me planin e prokurimit dhe menaxhimin e kontratave ishte adresuar kurse kishte vazhduar lidhja e kontratave për çmimet për njësi me procedurën e kuotimit të çmimit.	
Shpenzimet jo përmes prokurimit	Sekretari i Përgjithshëm përmes menaxherëve duhet të ushtrojë kontrole të shtuara te kontratat kornizë gjatë zbatimit të tyre në mënyrë që të gjitha specifikat e parapara me kontratë të implementohen në tërësi.	Ishte adresuar pas muajit qershor 2015 kur edhe ishte publikuar raporti i ZAP-it. Megjithëse ZAP këtë këshillë e kishte dhënë edhe në Memon e Auditimit në fund të dhjetorit 2014, dhe kjo kishte mundur të aplikohet nga fillimi i vitit 2015. Rekomandimi ishte zbatuar pas muajit qershor (Raporti i Publikuar) përkundër që ne kishim dhënë këshillë edhe në memon e auditimit në dhjetor	Pjesërisht pasi që pjesa në lidhje me formimin e komisionit ishte adresuar por vlera e paguar me diagnostifikim kishte vazhduar me përqindje mjaft të lartë.	

Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që menaxherët përgjegjës aplikojnë kontrolle të duhura para se pagesat e punëve jashtë orarit të procedohen për pagesë dhe të kalkulojnë saktë orët jashtë orarit të punës.	Po është zbatuar.		
Subvencionet dhe Transferet	Sekretari i Përgjithshëm duhet të vazhdojë të sigurojë se procesi i dhënies së subvencioneve bazohet në rregulla financiare dhe mbështetet me vendime përkatëse për të siguruar një monitorim efektiv.	Po është zbatuar. ZKA ka nxjerrë rregullore për S&T dhe për secilin subvencion nxjerrtet një vendim.		
Pasuritë Kapitale dhe Jo kapitale	Sekretari i Përgjithshëm duhet të diskutojë me MAP-in dhe rishikoj mundësitë e gjetjes së një zgjidhje për sistemin e-pasuria. Instalimi i sistemit e-pasuria apo një zgjidhje që mund të gjendet në kuadër të dy institucioneve do të jetë e pranueshme.			Nuk ishte zbatuar ky rekomandim
Sistemi i auditimit të brendshëm	Sekretari i Përgjithshëm duhet të analizojë arsyet e kufizimeve në kryerjen e auditimeve në vitin 2014 dhe sigurojë se plani i auditimit për vitin aktual është real dhe përfshin aktivitetet e vitit në mënyrë që të ndihmoj menaxhmentin në marrjen e vendimeve me kohë.	Ky rekomandim ishte zbatuar. AB nga katër auditimet e planifikuara për vitin 2015 tri i kishte përfunduar si dhe një raport i vitit paraprak.		